



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 36 Prot.

Vlorë, më 17 : 10 . 2018

VENDIM

Nr. 3 _ Data 10.10.2018 _

Për miratim të lejes së ujit për hidroenergji, për shfrytëzim të burimit ujqor të lumit Lengarica, të hidrocentralit "Lengarica " për prodhim të energjisë elektrike, Njësia Administrative Petran, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastër të subjektit "Lengarica Energy" me administrator Z. Ylli Halili

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligjit nr 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", , Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujqor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujqor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni",

VENDOSI

Miratim të lejes së ujit për hidroenergji, për shfrytëzim të burimit ujqor të lumit Lengarica, të hidrocentralit "Lengarica " për prodhim të energjisë elektrike, Njësia Administrative Petran, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastër të subjektit "Lengarica Energy" me administrator Ylli Halili me këto të dhëna:

Koordinatat KRGJSH: X 539780.34; Y 4458631.24; Z 410

Prurja mesatare : 5.17 m3/sek

Prurja e llogaritur: 8 m3/sek

Prurja e ekologjike: 0.2 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Godina e centralit X 535348.18 Y 4453146.45 Z 256

Fuqia e Instaluar e Hec "Lengarica" është 8906kw.

Për përdorimin e këtij burimi uJOR duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ